

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Notereve Vlore
Notere Mirela Gjonça

Nr. Rep. 68

Nr. Kol. 37

KONTRATE SHITJE KUOTASH

(Baza ligjore neni 164 i K. C. Sh (Fitimi i pronësive me kontrate) neni 73/b i ligjit "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar).

Ne Vlore, sot me daten 15 / Janar / 2020 (pesembedhete Janar dymije e njezete), perpara meje noteres, Mirela A.Gjonça, me zyre noteriale ne Vlore, Kulla 1, H. 10, Kati II, Njesia 2, kutia postare nr. 9401, Lagjia: "Lef Sallata", Bulevardi Vlore - Skele, kati i 2^{te}, u paraqiten:

Neni 1

Palet ne kontrate

Me cilesine e pales Shitese: z. Jonian Zihni Omeri, i datelindjes 22.07.1987, lindur ne Prenjas, Librazhd dhe banuese ne Vlore, lagja "Lirim, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda ne baze te leternjoftimit ID, me numer personal I70722110V.

Me cilesine e Pales Blerese: z. Genci Manesh Agalliu, i datelindjes 12.08.1970, lindur dhe banues ne Vlore, lagjia « Hajro Cakerri » madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda ne baze te leternjoftimit me nr. Personal H00812170I.

- te lartepemendurit madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, pas nje marreveshje paraprake me vullnetin e tyre te lire me kerkuan redaktimin e kontrates si me poshte vijon:

Neni 2

Objekti i kontrates

2.1. Pala shitesë Jonian Omeri, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise tregtare me pergjegjesi "Ferramenta Vlora" shpk, regjistruar ne Q.K.B me nr.NIPTI L47007202A, me seli ne Vlore rruga "Shyqyri Alimerko", lagjia "Pavarsia" zoteron ne baze te statutit dhe ekstraktit historik te leshuar nga QKB :

Vlera e Kapitalit: 2.000.000,00


Numri i pjesëve/kuotave: 100,00


Perqindja e pjesemarrjes : 100%

2.2. Ne baze te "Vendimit te Ortakut te vetem" te shoqerise "Ferramenta Vlora" sh.p.k date.09.01.2020, eshte miratuar transferimi me ane te shitjes i kuotave zoteruese te ortakut te vetem Jonian Omeri, ne favor te shtetasit z. Genci Agalliu

2.3. Me ane te ketij akti pala shitesë shet 100% te kuotave te kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine "Ferramenta Vlora" sh.p.k .

"Çmimi i shitjes së kuotave" i cili përbën vlerën monetare për të cilën palët kanë rënë që të







kryhet tjetërsimi i kuotave, eshte perkundrejt çmimit prej 2.000.000 leke,

Bleresi z. Genci Agalliu, i cili eshte dakort dhe blene kuoten e zoteruar nga shitesi si me siper përshkruar, Cmimi i shitjes eshte likujduar ne llogarine bankare te shitesit, mandati do te jete pjese integrale e kontrates.

2.4. Shtetasi z. Genci Agalliu, do te jete ne cilesine e ortakut te vetem, zoterues dhe pronar me te drejta te plota i 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise tregtare "Ferramenta Vlora" sh.p.k, pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 3
Te ndryshme

3.1. Pronesia e kuotes do te kaloje ne castin e nenshkrimit te kesaj kontrate. Regjistrimi i kalimit te kuotave prane Q.K.B ka efekt deklarativ per palet dhe i njoftohet personave te trete referuar neni 74 te LSHT-se.

3.2. Pas nenshkrimit te ketij akti noterial organet drejtues te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar: "Ferramenta Vlora" sh.p.k do te jene:

- **Ortaku i Vetem i shoqerise – z. Genci Agalliu.**
- **Detyren e Administratori te shoqerise do te vazhdoje ta ushtroje shtetasi z. Genci Agalliu**, i cili do te ushtroje cilesin e administratorit sipas afatit te pershkruar ne ekstraktin e QKB, deri ne daten 18.12.2024,

3.4. Kompetencat e administratorit te shoqerise si dhe Kompetencat e Ortakut te Vetem te shoqerise do te bazohen ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, ne aktet e shoqerise si dhe ne Legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise.

Teksi i kesaj Kontrate, pasi u lexua nga palet dhe u gjet se eshte ne perputhje te plote me vullnetin e tyre nenshkruhet pa verejtje ne prezencen time dhe pas nenshkrimit te tyre Une, Noterja e vertetova ate sipas ligjit me firmen dhe vulen time noteriale.

Akti i mesiperm lexohet me ze te larte dhe palet pasi e degjuan dhe lexuan me vemendje e kuptuan, firmosin me vullnet e tyre te lire per identitetin e te cileve une noterja jam e bindur.

PALET NE KONTRATE:

PALA SHITESE

PALA BLERESE

Unë noterja, pasi u binda për nënshkrimet e palëve në prezencën time, e vërtetoj atë duke e nënshkruar dhe vulosur sipas ligjit. Kjo kontratë u hartua në gjuhën shqipe në pesë kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore, një prej të cilave mbahet në arkivin e noterisë dhe një kopje depozitohet ne QKB, brenda 30-ditësh nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate.

NOTERE
MIRELA GJONÇA

